

## **Steering Committee i Dytë për Projektin Interconnect**

Në datën 12 dhe 13 Qershor 2018 është mbajtur në Bolonja të Italisë, mbledhja e dytë e Komitetit Drejtues të Projektit “*Inter-Connect-Promovimi i Intermodalitetit dhe Rilindja Hekurudhore në Rajonin Adriatiko-Jonian*”, të organizuar nga Instituti i Transportit dhe Logjistikës (ITL) dhe Rajoni Emilia-Romagna (RER). Drejtori i Rajonit Emilia-Romagna (RER) theksoi rëndësinë e bashkëpunimit të krijuar në kuadër të këtij projekti për zhvillimin e transportit hekurudhor për të gjithë rajonin. Gjatë takimit partnerët e projektit patën mundësinë të prezantonin dhe të merrnin feedback nga partnerët e tjerë, mbi rastet studimore të ndryshme, planin për zhvillimin e konsultimeve me personat e interesuar, statusin e mbledhjes së të dhënave, e po ashtu edhe për përfundimet e pritshme dhe më gjerë.

Partnerët e projektit janë në procesin e mbledhjes së të dhënave për formulimin e hartës transnacionale të lidhjes Adrion. Të gjithë partnerët ranë dakord mbi rëndësinë e lidhjes së të gjitha aktiviteteve teknike; duke gjetur në të gjitha rastet studimore informacion të vlefshëm për t'u shpërndarë me të gjithë dhe për të përcaktuar një metodologji të përbashkët për të gjetur mësimet më të rëndësishme.

Në ditën e dytë, Sekretariati i Përbashkët i Programit përditësoi të gjithë partnerët mbi raportet progreset, miratimin e manualit të zbatimit, datën e fillimit të funksionimit të faqes së internetit të programit dhe prodhimin e materialeve promovuese.